



Republika e Kosovës – Kosova Cumhuriyeti
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Mamuşa Belediyesi – Komuna e Mamushës
Opština Mamuša – Municipality Of Mamusa



Referenca: 626-20-015-1-3-6

Komuna e Mamushës, të cilën e përfaqëson Gazmend Gashi në cilësinë e Udhëheqësit të sektorit të Prokurimit (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërin anë;

Dhe

Operatori Ekonomik **N.T.SH. "KOSLABOR"** me numër të biznesit **810635188**, selia në Suharekë të cilin me autorizim e përfaqëson z. Bardhosh Zeqiraj, në cilësinë e agentit të shitjes (në vazhdim "Kontraktuesi"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për furnizime dhe shërbimet e shënuara më poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

"Furnizimi me pajisje specifike mjekësore për QMF-n në Mamushë"

Numri i Prokurimit: 626-20-2239-1-3-6

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate është furnizimi me pajisje specifike mjekësore për Qendrën e Mjekësisë Familjare në Mamushë.

1.2 Kontrata hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të saj nga ana e të dy palëve kontraktuese dhe do të realizohet brenda periudhës prej 30 ditëve.

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 30 ditë nga data e marrjes së urdhërësës.

1.4 Vendi i dërgimit të furnizimeve do të jetë në Mamushë. **Pajisjet duhet të dorëzohen dhe instalohen në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Mamushë.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksion do të ketë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **2 640,00 €**; Dymijë e gjashtëqindë e katëdhjetë Euro.

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro. Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve duhet në të gjitha aspektet të plotësojë specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Pajisjet duhet të jenë të kualitetit të lartë dhe ti plotësojnë specifikat teknike të paraqitura në dosje të tenderit në aneksin I. Pajisjet e dorëzuara duhet të kenë minimumi 2(dy) vite garancion të plotë (pa kosto shtesë për servisim dhe pjesë) duke llogaritur nga dita e pranimit teknik nga njësia kërkuuese.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së furnizimeve të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res-judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorit Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në *Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamentin për Çështje Ekonomike* në pajtim me ligjin e Kosovës.

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik


Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Bardhosh Zeqiraj	Emri:	Gazmend Gashi
Pozita:	Agjent i shitjes	Pozita:	Udhëheqës i sektorit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	18.06.2020	Data:	18.06.2020
Vula:		Vula:	



REPUBLIKA E KOSOVËS – KOSOVA CUMHURIYETI
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

MAMUŠA BELEDIYESI – KOMUNA E MAMUSHËS
OPŠTINA MAMUŠA – MUNICIPALITY OF MAMUSA




Pjesa II. PËRSHKRIMI I ÇMIMEVE

Titulli i Tenderit: "Furnizimi me pajisje specifike mjekësore për QMF-n në Mamushë"


Nr. i Prokurimit	626-20-2239-1-3-6
Nr i brendshëm	626-20-015-136

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME (Minimale) për materialin shpenzues higjienik

Nr.	Përshkrimi i artikullit	Njësia	Sasia	Çmimi për njësi me TVSH €	ÇMIMI TOTAL ME TVSH €
1.	Shtrat me rregullim të lartësisë-hidarulike Levizjet: Mbrapa, Trendelenburg dhe antitrendelenburg të kundërt, të rregullueshme me gaz, funksioni i Lartësisë është i rregullueshëm me pompë hidraulike. Me rrota të mëdha prej me frenim. Gjatësia e përgjithshme të jete në funksion të tejdukshëm për rreze x. Të gjitha pjesët metalike të dollapit prej çeliku inox. Foto për afërsisht. 	Copë	2	745.00	1,490.00
2.	Karroçë mjekësore për qëllime të përgjithshme Trupi kryesor është bërë nga mediapan 25 mm, fundi dhe pjesa sipër nga MDF 18 mm. • Gjithsej 28 kuti polarbarbonate anti-bakteriale në të dy anët. • Raft, sirtar, mbajtës i skedarëve dhe kosh i mbeturinave në karrocë.	Copë	1	575.00	575.00



• Baza e monitorit të kthyeshëm 360 ° mund të vihet në karrocë.
Foto e përafërt.




Paravan 3 pjesesh

Panelet janë bërë prej mediapanit 8 mm. , skajet janë profil prej druri.

• Panelet e skajit janë të luajtshme dhe të palosshme.
Dim. e përafërta. 205x50x175cm

Foto përafërsisht.

3.



Copë

2

100.00

200.00

Karroce per invalide- standarde e paloseshme

GJERESIA STANDARDE - 46 cm

- shirit i vetëm kryq
- kornizë e kromuar
- Mbështetëse fikse, jastëk PVC
- Mbështetëse fikse, pllaka rrokullisëse me rrip këmbësh
- Rrotë të ngurta min. 20 cm (8 ")
- rrota të pasme të forta min. 61 cm (24 ")
- mbyllje e frenave në rrotat e pasme
- xhep i madh në anën e pasme

Specifikacionet teknike:

Gjeresia totale: 64 cm

Gjeresia e karroces se paluar: 24 cm

- Gjeresia e uleses: 46 cm
- Diametri i rrotes se prapme: 58 cm
- Diametri i rrotes se perparme: 20 cm

4.


• Copë

1

110.00

110.00



	• Lartesia e uleses: 49 cm • Lartesia totale e karroces: 87 cm • Gjatesia totale: 106 cm • Thellesia e uleses: 40 cm • Lartesia e uleses: 45 cm • Pesha bartese min: 100 kg				
5.	Kabinete medicinale me sirtare (gjysma me qelq) Dim. afersishte. 42 cm. 90 cm. 180 cm. Bere nga metali me min. 0.8mm Me bojë antistatike Gjysma e kabinetit me qelq, plus dy sirtare Pjesa e poshtme me mbyllje çelës (mbyllet) 	Copë	1	265.00	265.00
Totali i përgjithshëm duke aplikuar të gjitha taksat dhe tatimet					€ 2,640.00

IDENTIFIKIMI I OPERATORIT EKONOMIK	
EMRI I KOMPANISË	NTSH "KOSLABOR"
ADRESA E PLOTE	LAGJA E RE NR.5 23000 SUHAREKE
PËRFAQËSUAR NGA:	
EMRI & MBIEMRI	DR.HAMEZ ZEQRARJ
POZITA	DREJTOR
NËNSHKRIMI	
DATA	01.06.2020
VULA	

